



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
Periudha raportuese	Muaji Mars 2024
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Znj. Donika Çetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/curisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Shkurt realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për reaktivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushës së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Gjelbër”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

3.AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -

- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;
- Përgatitja e projekteve për tenderim;
- Mbikqyrja e punëve në Parkun e Drenocit;
- Regjenerimi i hapësirës gjelbëruese në Pakrun Linear;
- Shënimi i Ditës së Pranverës në Parkun e Qytetit dhe atë të Taukbashqes;
- Inagurimi i Këndit të lodrave në lagjen Kolovica dhe mbjellja e drunjëve dhe luleve sezonale për të shënuar Ditën e Pranverës;
- Shtrirja e sistemit të ujitjes dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;

5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Numri i lëndëve të pranuar:18

Numri i lëndëve të kryera:18

Numri i lëndëve të refuzuara: 0

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 9

6. Takime të tjera:

- Takim me Drejtoreshën e Kulturës;
- Takim me Raiffeisen Bank Kosova;
- Takim me Sigma;
- Takim me Institutin për Mbrojtjen e Natyrës;
- Takim UNDP;

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –

- Përgaditja dhe inicimi i projekteve per tenderim;
- Përrurimi i Parkut Linear në lagjen e Spitalit;
- Shënimi i Ditës së Tokës;
- Fillimi i punimeve në Parkun e lodrave në Ulpianë etj.